



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

KRYETARI I KOMUNËS

01. Nr. 029/04-009/1037/17 më 20.04.2017

Në bazë të neneve 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 11, paragrafit 6 të Ligjit Nr. 04/L - 106 për Teatrot e datë 24.05.2011, Kryetari i Komunës së Prishtinës, merr këtë

V E N D I M

- I. Miratohet vendimi për emërimin e Këshillit Drejtues të Teatrit "Dodona" në Prishtinë.
- II. Anëtarët e Këshillit Drejtues të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:
  1. Drita Rudi, përfaqësuese e Komunës së Prishtinës;
  2. Besnik Krapi, aktor dhe producent;
  3. Ismet Sijarina, regjisor;
  4. Dardane Mehmeti, aktore;
  5. Albena Reshitaj, dramaturge.
- III. Detyrat e Këshillit Drejtues të cekur në pikën II të këtij Vendimi janë:

Të mbikëqyrë punën e teatrit, aprovon politikat afatgjata të zhvillimit të teatrit dhe politikën artistike, me propozim të drejtorit të përgjithshëm miraton planin vjetor buxhetor të teatrit, me propozim të udhëheqësit artistik dhe në përputhje me buxhetin vjetor miraton programin artistik vjetor të teatrit, shqyrton dhe miraton raportin vjetor financiar të teatrit, harton dhe propozon statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të teatrit, të cilat i miraton asamblea komunale, interviston kandidatët dhe zgjedhë drejtorin e përgjithshëm dhe udhëheqësin artistik, inicon procedurën dhe shkarkon drejtorin e përgjithshëm dhe udhëheqësin artistik, si dhe merr vendime me shumicë absolute të votave të të gjithë anëtarëve.
- IV. Për kryerjen e detyrave të cekura në pikën III të këtij Vendimi, Këshilli Drejtues i raporton Kryetarit të Komunës së Prishtinës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e marrjes së tij.

I DORËZOHET:

- Anëtarëve të KD;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.

20.04.2017



Kryetari i Komunës  
Shpend Ahmeti